

VENDIM
Nr. 482, datë 24.7.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHITESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË
PUNE PËR DREJTORIN E PËRGJITHSHËM DHE NËPUNËSIT NË NJËSITË
TEKNIKE TË PËRMBAJTJES SË AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË
KIBERNETIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e Përgjithshëm dhe nëpunësit e njësive teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike është sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Vendimi nr. 763, datë 12.12.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e Përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Efektet financiare të këtij vendimi, për vitin 2024, fillojnë nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë dhe përballohen nga fondet e miratuara për këtë vit për Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.
4. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

**MASA E SHITESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE PËR DREJTORIN E PËRGJITHSHËM DHE
NËPUNËSIT E NJËSIVE TEKNIKE TË PËRMBAJTJES SË AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË
KIBERNETIKE**

NR. RENDOR	POZICIONI	MASA E SHITESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE
1	Titullar i institucionit.	710 000
2	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm dhe drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e konformitetit të certifikimeve, qeverisjes së sigurisë kibernetike, kontrollit të masave të sigurisë kibernetike, zhvillimit strategjik, analizës së riskut, analizës së sigurisë kibernetike, monitorimit dhe reagimit të incidenteve.	235 000
3	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes, përgjegjës për funksionet e konformitetit të certifikimeve, garantimit të transaksioneve elektronike në treg, kontrollit të masave të sigurisë kibernetike, simulimit, monitorimit të thelluar, reagimit të incidenteve kibernetike, analizës së riskut, analizës së sigurisë kibernetike, menaxhimit të incidenteve kibernetike, qeverisjes së sigurisë kibernetike, mbrojtjes kibernetike dhe hetimit të incidenteve kibernetike. Koordinator.	180 000
4	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes, përgjegjës për funksionet e monitorimit të jashtëm, politikave, çështjeve ligjore, analizës së	110 000

	indikatorëve, statistikave dhe modeleve, komunikimit, ndërgjegjësimit dhe zhvillimeve strategjike.	
5	Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes, përgjegjës për funksionet e konformitetit të certifikimeve, garantimit të transaksioneve elektronike në treg, kontrollit të masave të sigurisë kibernetike, simulimit, monitorimit të thelluar, reagimit të incidenteve kibernetike, analizës së riskut, analizës së sigurisë kibernetike, menaxhimit të incidenteve kibernetike, qeverisjes së sigurisë kibernetike, mbrojtjes kibernetike dhe hetimit të incidenteve kibernetike.	176 000
6	Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e monitorimit të jashtëm, politikave, çështjeve ligjore, analizës së indikatorëve, statistikave dhe modeleve, komunikimit, ndërgjegjësimit dhe zhvillimeve strategjike.	106 000